

Termet e Referencës

Ekspert për vlerësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin fillor në Komunën e Prishtinës

Organizata	HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Projekti:	<i>Strengthening the rights of persons with disabilities</i>
Zbatohet nga:	HANDIKOS
Qëllimi i Angazhimit	Vlerësimi i pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, në arsimin fillor në Komunën e Prishtinës
Vendi	Prishtinë, Kosovë
Data e shpalljes dhe mbylljes së aplikimit	23.02.2024 deri me 09.03.2024
Data e pritur e angazhimit	15.03.2024
Kontakti	handikos@handi-kos.org

1. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Organizata përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të projektit do të angazhohet një ekspert / kompani me qëllim të vlerësimit të situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të përfshirë në arsimin fillor në Komunën e Prishtinës dhe cilat janë arsyet që fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë të përfshirë në arsimin fillor.

2. OBJEKTIVA E DETYRES

- Eksperti/ja do të angazhohet me qëllim të vlerësimit të pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit fillor në komunën e Prishtinës, si dhe të bëjë vlerësimin e arsyeve të mos përfshirjes të fëmijëve në sistemin arsimor, si dhe vlerësimin e shkaktarëve që kanë ndikuar që fëmijët me aftësi të kufizuara ta braktisin shkollën.
(8 ditë pune)
- Eksperti/ja për këtë qëllim do të përgatisë një raport bazuar në të gjeturat në terren
(2 ditë pune)

Gjithsej 10 ditë pune

3. FUSHEVEPRIMI

- Eksperti/ja do të përgatisë një pyetësor lidhur me objektivin dhe në bazë të pyetësorit të bëjë vizita dhe takime me drejtorët e shkollave fillore dhe mësimdhënësit për të evidentuar pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, si dhe për të evidentuar rastet e braktisjes së shkollave.
- Po ashtu eksperti/ja do të bëjë vizitë tek familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në ato raste kur identifikohen rastet e braktisjes së shkollës për të mësuar arsyet e braktisjes.

4. METODAT DHE MJETET

Metodat e mëposhtme mund të përdoren për detyrat e përmendura më lart dhe për të përmbushur qëllimin siç përcaktohet nga ky ToR.

- Takime konsultative me HANDIKOS dhe ekipin e Projektit
- Vizita e drejtpërdrejt në shkollat fillore, me qëllim të vlerësimit të situatës
- Vizita tek familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara (sipas vlerësimit të ekspertit)

5. SHKATHËSITË, PËRVOJA DHE KUALIFIKIMET PËR EKSPERTIN

Eksperti/Kompania duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Përvojë pune në mbledhjen e të dhënave
- Të njohë mirë legjislacionin për arsimin e Kosovës, si dhe përgjegjësitë e nivelit lokal në fushën e arsimit.
- Përvojë pune në planifikim dhe raportim.
- Aftësi të shkëlqyer të komunikimi me fëmijët dhe të rinjtë
- Të jetë i diplomuar së paku në nivelin B.A në fakultetin Juridik, Ekonomik, ose në fushat e shkencave sociale.

6. KOHEZGJATJA E ANGAZHIMIT

- Kohëzgjatja e angazhimit planifikohet të jetë nga muaji Shkurt deri në muajin Mars, me gjithsej 10 ditë pune gjatë kësaj periudhe.

7. MATERIALI PER DETYREN

- Eksperti/ja do të punojë ngushtë me ekipin e projektit HANDIKOS. Të gjitha materialet do t'i dorëzohen ekipit të Projektit HANDIKOS në datën siç është rënë dakord gjatë takimit fillestar. Raportet do të rishikohen dhe për këtë ekspert/ja do të jete në gjendje që të i përgjigjet pyetjeve eventuale

8. REZULTATET E PRITURA

- Sa fëmijë me aftësi të kufizuara janë pjesë në arsimin fillor në Komunën e Prishtinës
- Sa fëmijë me aftësi të kufizuara e kanë braktisur arsimimin në Komunën e Prishtinës
- Cilat kanë qenë arsyet e braktisjes së arsimimit nga fëmijët
- Rekomandime për institucione
- Si dhe të dhëna të tjera në bazë të vlerësimit të ekspertit

9. PROCEDURA PER APLIKIM

Eksperti /kompania e interesuar duhet të paraqesë dokumentet e përmendura më poshtë

- Një CV (Maksimumi 3 faqe)
- Një letër motivim me të cilën ndërlidhet eksperiencia me pozitën e shpallur.
- Koncepti lidhur me planin e punës.
- Ofertën Financiare

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për “Ekspert për vlerësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim”

Dokumentet duhet te dorëzohen vetëm në formën elektronike ne adresën: handikos@handi-kos.org

Aplikimi është i hapur nga data 23.02.2024 deri më datë 09.03.2024. Vetëm kandidatet e listës së ngushtë do të kontaktohen.